

BIBLIOTEKA

E

8JH-1

M 98

GJIROKASTER

SHTEFTE

BESNIK
MUSTAFAJ




*Pragu
iverës*

POEZI

81H-1
M 98

**Besnik
Mustafaj**



33/43

**Pragu
i verës**

poezi

SHTËPIA BOTUESE «NAIM FRASHERI»

JETA E UDHEVE

shokëve të mi gazetarë

Ec!

Mbi sytë e tu, në zemrën tënde
udha shkruan jetën e vet.

Udha s'është udhë pa udhëtarë.
Shoferi i kamionit që të gjeti në shi,
qortimi miqësor i një minatori
duke pirë kafe me të
se nuk zbrite ta takosh atje poshtë,
një vajzë fshati që të sheh në sy
pa u skuqur më, të sjell ujë nga shtëpia
të pastrosh baltën e fushës në këpucë,

një dorë veterani mbështetur në sup,
këmbëngulja e singertë t'i shkosh për drekë,
një fëmijë i panjohur që të pyet për orën
e rënd në shkollë të kap mësimin;
përherë, pérherë
në udhet tonë nuk ngelesh vetëm.

Në mëngjes e në mbrëmje, ditën e natën
ec!

Zgjerojen sytë, zgjerohet zemra.
Pambarimisht udha kërkon vend
për të shkruar aty jetën e yet:

Burrizma e mësuesit

1931

Lezhë, 15. Janar 1931. Në shtator 1931
në Lezhë, mësuesit

Mësuesit e shkollave fillore
dhe profesionale
Mësuesit e shkollave teknikore
Mësuesit e shkollave teknologjike
Mësuesit e shkollave teorektore
Mësuesit e shkollave teorektore
Mësuesit e shkollave teorektore

TRI KËNGË PËR NËNËN

1. Nëna

Nëna, e heshtura,
në rrembat e gjakut tonë, në zemër.

Në rrugët ku hyjmë, të mëdha e të vogla,
kudo shkojmë, kudo ecim,
para se të vëmë këmbën ne
në tokë mbështetet këmba e nënës
e prövon fortësinë e saj.

Aty ku mund të shfaqen sirenat
na zë veshët,
aty ku duhet të këndojmë, të qeshim,
bëhet dritë në buzët tona, në sy.

Ulici kujtonte se ish Athinaja,
e s'e dinte se ajo ish, nëna.

MEMRI JESI QELQIJA LSI

2. Përsëri për nënën

Dikush i tha nënës se kishte djalë të mirë, nëna ime vetëm qëshë pak.

Kur erdhi në shtëpi, në darkë, puthi fotografinë time, në tryezë shtroi një pjatë më shumë.

Dhe u ul aty ku ulesha unë...

3. Letër nënës

E dashur nënë!

U bënë muaj pa të parë.

Një punë e re që dël papritur

MAT

ma shtyn më larg ardhjen pér ditë.

Ti asnijëherë, asnijëherë
të lyp të falur s'më kërkon,
vec ndiej nga larg si psherëtin
kur më thua se je mirë.

Me zérin tim ende në vesh
mendon me vete pér një çast:
«Ký biri im... mirë, mirë,
u' bëftë punëtor!»

Le të mësojë se dita e tij
edhe pér mua gjithnjë ka kohë».
Kaq mund të thuash, ti je nënë,
s'do kurrsesi që djalit tënd
ti flasin ashpér, ta qortojnë,
se paska lënë një punë pa bërë
të vijë thjesht sa të të shohë».

Kaq mund të thuash, ti je nënë.

TANI

Tani nuk rritem më. Eshtrat janë lidhur me njëra-tjetrën, secila në vendin e vet. Numri i këpucëve s'ndryshon më. Ushqehem me rrögën time. Kam gruan sa vetja dhe pres fëmijë. Të tjerët s'thonë më: «I biri i filanit». Kam emrin tim.

I kam të gjitha këto gjëra të thjeshta, të përditshme brenda në trupin tim si jetë e jashtë si stoli. Thellë shpirtit kariqë nisur të më zgjohën vullkanet nga oshëtima e gjakut më deje prej dhirrjes së jetës.

HERONJTË

Unë isha i vogël e heronjtë shumë të mëdhenj,
shumë më të lartë se trupat e statujave të
Duke u irritur, gjithnjë e më pak i shihja nga
sa erdhi mosha kur u pamë sy mësy.
Tani unë kisha hyrë brenda tyre thellë
dhe kisha zbuluar tek ata njerëzit e thjeshtë
që me dashurinë e natyrshme për gruan, fëmijët,
e ngrohnin edhe pragun e shtëpive.

Dhe kjo dashuri i bëri heronj.

DONIKA

Flasim për Gjergjin,

për ditët e netët e gjata të rrëthimeve,
për luftërat e rrepta, fitoret,
për kafin e tij të zgjuar dhe për shpatën e
por shpesh të harrojmë ty.

Harrójmë si kthehej ai i lodhur nga betejat
dhe te derave prisje ti.
I merrje në trupin tënd dhimbjet e plagëve të
të fushave të djegura me grurë,
të pusevë të shterrura pa ujë
për të mos ia lënë atij.

Se ai duhej të pushonte pak
për të qenë përsëri nesër për luftë.